S T A T U T
të Sindikatës së Pavarur për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të Republikës së Maqedonisë

1.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Sindikata e pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë në Republikën e Maqedonisë është e pavarur, demokratike, organizatë e pavarur e punonjësve në të cilën në mënyrë vullnetare anëtarsohen për përfaqësim, arritje, mbrojtje, zbatim dhe promovim të interesave ekonomike, sociale, puno-ligjore, profesionale, edukative, kulturore dhe interesa të tjera individuale dhe kolektive.

Neni 2

Në shprehjen dhe mbrojtjen e interesave, Sindikata e Pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë nis vetëm nga vullneti i anëtarësisë së saj.

Neni 3

Në udhëheqësitë e organizatave sindikale dhe në organet e sindikatës së Pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë nuk mund të propozohen dhe të zgjidhen:

- drejtorë dhe punonjës udhëheqësish të cilët punëdhënësi i ka autorizuar që të marrin vendime të lidhura me marrëdhënien e punës së punonjësve.

Neni 4

Sindikata e pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë ka të drejtë të anëtarësohet në shoqatat në vend dhe jashtë tij.

2. EMRI DHE SELIA

Neni 5

Emri i Sindikatës është: Sindikata e Pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë e Republikës së Maqedonisë.

Sindikata e pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë e ka shkurtesën e saj: SASHK (në tekstin e mëtejmë: SASHK).

Selia është në Shkup, në rr.,, Maxhir Maalo nr.36 - Shkup.

3. PRINCIPET E SASHK-UT

Neni 6

SASHK-u e themelon veprimtarinë e tij si në principet në vijim:

- vullnetarizëm në anëtarsim;
- demokraci në shprehje dhe vendimmarrje;

- reciprocitet dhe solidaritet;
- të drejta dhe përgjegjësi të anëtarëve dhe organeve të SASHK-ut;
- informacion pubik.

4. QËLLIME DHE METODA

Neni 7

Qëllimet e SASHK-ut janë:

- ngritje e statusit socio-ekonomik të anëtarësisë;
- mbrojtje e të drejtave të marrëdhënieve të punës;
- ngritja e dialogut social, në pajtim me standardet ndërkombëtare;
- Negocim kolektiv dhe lidhje të marrëveshjeve kolektive në nivel të degëve dhe të punëdhënësit;
- Pjesëmarrje në krijimin e politikave arsimore, shkencore dhe kulturore, në procedurë të miratimeve të ligjeve;
- avancim në kontiunitet të kushteve të punës;
- të drejta më të mëdha të sigurimit social, shëndetësor dhe atij penzio-invalidor:
- të drejta më të mëdha për pushimet ditore, javore dhe atyre vjetore;
- mbrojtje shëndetësore më efikase;
- realizim i bashkëpunimit sndikal ndërkombëtar.
-

Neni 8

SASHK-u i arrin qëllimet përmes:

- përfaqësimit të anëtarësisë;
- platformave, programeve, qëndrimeve, kërkesave dhe të ngjashmeve, në lidhje me çështjet socio-ekonomike, puno-ligjore dhe profesionale si dhe realizimin e tyre;
- negocim dhe kontraktim të marrëveshjeve kolektive si dhe pjesëmarrje në këshillet socio-ekonomik;
- propozime më të volitshme për ndryshime dhe plotësime në akte ligjore dhe akte të tjera dhe propozime për ligje dhe zgjidhje të reja, të tjera;
- forma të ndryshme të presionit sindikal: letra dhe deklarata protestuese, tubime dhe mitingje publike, shëtitje protestuese, demonstrata dhe greva;
- informim i opinonit përmes njoftimeve, konferencave për shtyp, paraqitjeve të drejtpërdrejta përmes mediumeve publike, shfaqjes së afisheve në vende publike, në faqe të internetit dhe të tjera;
- publikim të gazetave, manualeve dhe materijaleve të tjera të shtypura;
- njoftime dhe kërkesa për mbështetje nga organizatat ndërkombëtare.

5. ANËTARSIA E SASHK-UT

Neni 9

Anëtarë të SASHK-ut mund të jenë punonjësit në veprimtaritë: kujdestari dhe edukim të fëmijëve, të arsimit fillor, arsimit të mesëm, arsimit të lartë, të shkencës, kulturës, sportit: penzionerët nga këta veprimtari që ishin anëtarë të SASHK-ut para penzonimit: studentët e fakulteteve nga të gjitha universitetet në vendin tonë dhe të punësuarit në Shërbimin Profesional të Këshillit të SASHK-ut.

Neni 10

Anëtarësimi në SASHK bëhet vullnetarisht pavarsisht bindjeve politike dhe religjioze, atyre nacionale, etnike, racore dhe gjinore.

Neni 11

Punonjësit në veprimtaritë nga neni 9 i këtij Statuti në bazë të vullnetit të lirë, bëhen anëtarë të SASHK-ut me të nënshkruarit e aplikimit, me çka vërtetohet pranimi i Statutit dhe Program i SASHK-ut.

Punonjësit, pas dorëzimit të aplikimit të nënshkruar në organizatën sindikale në të cilën është anëtar, i jepet një librezë anëtarsimi me të cilën e dëshmon anëtarësinë në SASHK.

Libreza e anëtarsimit është pronësi e SASHK-ut.

Neni 12

Anëtasia në SASHK paraqet:

- dhënia e dorëheqjes vullnetare e anëtarit, bëhet me dorëzimin e Kërkesës me shkrim deri te kryetari i organizatës sindikale, me çka e kthen librezën e anëtarsimit në SASHK;
- me autimatizëm;
- me largim nga SASHK-u.

Pa mos e kthyer librezën e anëtarësimit në SASHK, largimi vullnetar është i pavlefshëm.

Largimi kolektiv nga SASHK-u është i pavlefshëm.

Neni 13

Anëtari nuk mundet në mënyrë vullnetare të largohet nga SASHK-u poqese ka përdorur mjete financiare në emër të solidaritetit nga mjetet e SASHK-ut, pa marr parasysh nëse bëhet fjalë për mjete të organizatave sindikale, bordeve Rajonale, mjete të Këshillit të SASHK-ut, fondit Sindikal apo fondeve të tjera të SASHK-ut.

Largimi vullnetar është i pavlefshëm edhe në rastet kur anëtari e ka ushtruar të drejtën që është e siguruar me marrëveshje Kolektive, të nënshkruar nga ana e SASHK-ut apo me ndonjë dokument tjetër (Marrëveshje, kontratë dhe të ngjashme) me autoritetet e partnerëve social, edhe atë në të gjitha nivelet, e me përdorimin e disa prej atyre të drejtave, anëtari ka marrë rritje të mjeteve financiare apo ngritje të statutit në vendin e punës, si dhe lirimin nga dënimet që dalin nga organet kompetente shtetërore (inspektimet, organet drejtuese në institucion, gjykatat dhe të ngjashme) si meritë e masave dhe aktiviteteve të organeve të SASHK-ut.

Neni 14

Anëtari i SASHK-ut, i cili vulnetarisht dëshiron të largohet nga SASHK-u, në pajtim me bazat e përcaktuara në nenin 13 nga ky Statut, largimin mund t'a bëjë pas 3 viteve që nga dita e e parashtrimit të Kërkesës për largim nga SASHK-u.

Anëtarit, i cili ka parashtruar Kërkesë për largim nga SASHK-u, në periudhën e parashikuar në paragrafin 1 nga ky nen, anëtarësia do t'i lihet në pezullim dhe nuk do të vlejnë dispozitat e nenit 18 dhe 19 nga Statuti i SASHK-ut, përveç detyrimit që të paguajë anëtarësi deri në skadimin e periudhës së pezullimit.

Neni 15

Anëtari fshihet nga evidenca e organizatës sindikale me automatizëm, poqese i ndërpritet marrëdhënia e punës në institucion për çfarëdo arsye.

Neni 16

Largimin e bën organizata sindikale, aty ku është i organizuar anëtari. Kjo masë zbatohet në raste të mosrespektimit të Statutit të SASHK-ut dhe, vendimeve të organeve të SASHK-ut.

Vendimi për largimin e anëtarit dorëzohet në afat kohor prej 15 ditëve, pra, që nga miratimi i tij.

Anëtari, ndaj të cilit zbatohet masa e largimit, ka të drejtë ankimi deri te Këshilli i SASHK-ut. Nëse anëtari i larguar parashtron ankesë deri te Këshilli i SASHK-ut, anëtarësia e tij pezullohet. Nëse, Këshilli i SASHK-ut e refuzon ankesën, atëherë largimi është fuqiplotë.

Neni 17

Nëse anëtari, të cilit i ka përfunduar anëtarësia, shpreh dëshirë që përsëri të anëtarësohet në SASHK, duhet që me shkrim të drejtohet deri tek organizata sindikale.

Organizata sindikale në mbledhjen e saj, të parë, të ardhshme mund të vendos t'a pranojë në anëtarësi bazuar në dëshirën vullnetare për largim nga SASHK-u dhe, t'a regjistrojë atë në evidencë, duke i dhënë librezë të re anëtarësie.

Sipas rregullave, anëtari i cili në mënyrë vullnetare është larguar nga SASHK-u, pa asnjë arsye objektive, nuk duhet që përsëri të anëtarësohet në SASHK.

6. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT TË SASHK-UT

Neni 18

Anëtari i SASHK-ut i ka të drejtat si në vijim:

- të merr mbrojtje nga SASHK-u - për ushrimin e të drejtës për punë;
- të shfrytëzojë të drejta nga marrëveshjet kolektive;
- të shfrytëzojë të drejta nga fondi Sindikal dhe fondet e tjera të SASHK-ut;
- të shfrytëzojë ndihmë dhe mbrojtje ligjore falas;
- të propozojë, të zgjedh dhe të zgjidhet në organet e SASHK-ut;
- të merr pjesë në vendimmarrje dhe në realizimin e vendimeve në organizatat sindikale;
- lirshëm ta shprehë mendimin e tij dhe ta mbrojë atë në mbledhje, konferenca, këshille dhe kongrese;
- të merr informata për aktivitetet sindikale të organeve të SASHK-ut;
- deri te organet sindikale - të dorëzojë kërkesa, opinione, propozime, vërejtje kritike dhe ankesa që kanë të bëjnë me probleme më të rëndësishme sindikale dhe të kërkojë përgjigje dhe aktivitet për zgjidhjen e tyre;
- të merr pjesë në punën e organizatës sindikale;
- edukim sindikal;
- të merr shpërblime dhe mirënjohje nga SASHK-u për aktivitetin sindikal;
- prokurim më të volitshëm të nevojave themelore jetike përmes organizatës sindikale;
- të ushtrojë edhe të drejta të tjera të cilat do t'i sigurojë SASHK-u .

Neni 19

Anëtari i SASHK-ut i ka këta detyrime, si në vijim:

- t'a respektojë dhe t'a zbatojë Statutin e Programit të SASHK-ut;
- t'i respektojë dhe t'i zbatojë vendimet e Kongresit dhe të organeve të SASHK-ut;
- të kontribuojë për unitetin e SASHK-ut dhe ta mbrojë autoritetin e tij;

- të mos veprojë në aktivitetet e SASHK-ut nga pozicionet politike, përkatësitë nacionale, etnike apo racore, si dhe në bindjet fetare;
- të paguajë rregullisht anëtarësim sindikal;
- gjatë kalimit në një organizatë tjetër të SASHK--ut të lidhet më së voni për 30 ditë.

7. ORGANIZATA SINDIKALE E SASHK-UT

Neni 20

Organizata sindikale e SASHK-ut (në teksin e mëtejmë: organizata sindikale) është një formë themelore në organizimin e SASHK-ut.

Organizata sindikale ka status të një personi juridik dhe llogari bankare.

Neni 21

Pas iniciativës të punonjësve formohet organizata sindikale. Inicim për formimin e organizatës sindikale mund të japin grupe të punonjësve në institucion.

Thirrjen e Asamblesë Kushtetuese të organizatës sindikale e bën bordi Inicues, me më së paku tre punonjës.

Vendim për formimin e organizatës sindikale merr Asambleja Themeluese e organizatës sindikale dhe e njëjta dorëzohet deri te Shërbimi Profesional i Këshillit të SASHK-ut.

Që të formohet organizatë sindikale duhen më së paku tre anëtarë.

Neni 22

Organizata sindikale formohet në parim: një institucion, një organizatë sindikale e SASHK-ut.

Neni 23

Organizata sindikale kryen funksione dhe detyra të cilat dalin nga Statuti i Programit të SASHK-ut, dhe në veçanti:

- merr pjesë në debat gjatë procedurës për miratimine marrëveshjeve kolektive dhe angazhohet për zbatimin e tyre;
- merr pjesë në debat gjatë procedurës për miratimin e akteve në institucion, me të cilat rregullohet pozita ekonomike dhe sociale e anëtarësisë;
- sipas nevojës, lidh marrëveshje Kolektive në nivel të punëdhënësit;
- propozon kandidatë të mundshëm për anëtarë në organet e SASHK-ut:
- merr vendime për grevë në nivel të organizatave sindikale dhe formave të ndryshme të të shprehurit edhe revolt, për çështje që janë në kompetencën e organeve të institucionit tek punëdhënësi në të cilën vepron organizata sindikale.

Neni 24

Organizata Sindikale mund të punojë nëse të pranishëm janë më shumë se gjysma e anëtarëve, ndërsa vendimet merren me shumicën e të pranishmive.

Neni 25

Organet e organizatës sindikale janë: Kuvendi, bordi Mbikqyrës dhe kryetari.

Neni 26

Kuvendin e përbëjnë të gjithë anëtarët e organizatës sindikale dhe mbahet një here në pesë vite apo sipas nevojës.

Kuvendi mund të mbahet nëse të pranishëm janë më shumë se gjysma e anëtarëve të organizatës sindikale, ndërsa, vendimet miratohen me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Kuvendi e vlerëson punën e kryetarit dhe e miraton Raportin e bordit Mbikqyrës.

Kuvendi zgjedh kryetar, sekretar të organizatës sindikale dhe bord Mbikqyrës. Kryetari zgjidhet sipas mendimit paraprak të marrë nga Bordi Rajonal i SASHK-ut, ku anëtare është organizata sindikale.

Dokumentacioni përgatitet në dy kopje, njëra kopje ruhet në arkivën e organizatës sindikale ndërsa tjetra i dorëzohet shërbimit Profesional të Këshillit të SASHK-ut.

Kuvendi mund të debatojë dhe të vendosë për shkarkimin e kryetarit të organizatës sindikale dhe anëtarëve të bordit Mbikqyrës, poqese ata e kanë shkelur Statutin e SASHK-ut dhe Vendimet e Këshillit të SASHK-ut. Pas Vendimit për shkarkimin e tyre, të njëjtit kanë të drejtë ankimi deri te Këshilli i SASHK-ut, i cili me dy të tretën e shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit vendos për ankesën, ndërsa vendimi i Këshillit është përfundimtar.

Mandati i kryetarit dhe i sekretarit zgjat pesë vite, me mundësi që përsëri të rizgjidhen.

Neni 27

Kryetari i organizatës sindikale thërret mbledhje dhe udhëheq me të njejtat.

Mbledhje e organizatës sindikale thirret edhe pas nënshkrimeve të dorëzuara deri te kryetari i organizatës sindikale nga më së paku një e treta e anëtarëve të organizatës sindikale, me kërkesë me shkrim për mbajtjen e mbledhjes, me propozim të rendit ditor të mbledhjes. Kryetari thërret mbledhje më së voni në afat prej 30 ditëve.

Neni 28

Kryetari i organizatës sindikale i ka detyrat si në vijim:

- e monitoron pozicionin ekomonik dhe social të anëtarësisë së organizatës sindikale, ngre iniciativa dhe kërkesa si dhe propozon zgjidhje për përmirësimin e të njëjtës para punëdhënësit;
- negocion edhe pas autorizimit të organizatës sindikale, nënshkruan marrëveshje Kolektive me punëdhënësin dhe e monitoron zbatimin e tij;
- i mbron të drejtat e punësimit dhe i përfaqëson anëtarët gjatë zbatimit të tyre në institucion;
- angazhohet për krijimin dhe përmirësimin e kushteve për punë dhe mbrojtje gjatë punës;
- angazhohet për sigurimin e kushteve për t'i kënaqur nevojat nga kultura, rekreacioni, pushimi dhe sportimi i anëtarësisë;
- ka për detyrë që me kohë dhe në mënyrë të saktë t'a informojë anëtarësinë, organet dhe trupat të SASHK-ut;
- i përcjell pikëpamjet e organizatës sindikale në bordin Rajonal të SASHK-ut;
- kujdeset për llogaritjen në kohë dhe saktësinë e pagesës tarifore për anëtarët sindikal, për secilin anëtar në organizatën sindikale gjatë llogaritjes së pagave mujore, në pajtim me Vendimin e Këshillit të SASHK-ut për shpërndarjen tarifore të anëtarësimit;
- ndëmerr aktivitete për anëtarësimin e anëtarëve të ri në Sindikatë.

Kryetari është nënshkruesi i të gjitha dokumenteve të organizatës sindikale dhe është urdhërdhënës i mjeteve.

Kryetari e ruan dokumentacionin, vulën dhe shtambilin e organizatës sindikale dhe e përfaqëson organizatën sindikale në qarkullimin tarifor - ligjor edhe ndaj palëve të treta.

Neni 29

Në mungesë të kryetarit, kompetencën e tij e ushtron sekretari.

Pas përfundimit të mandatit të kryetarit, për çfarëdo lloj arsye, dokumentacioni, shtambili dhe vula i dorëzohen kryetarit të sapozgjedhur apo në rast se nuk ka të zgjedhur atëherë i dorëzohen sekretarit të organizatës sindikale.

Член 30

Kuvendi i organizatës sindikale zgjedh bord Mbikqyrës prej tre anëtarëve dhe tre zëvendësve. Bordi Mbikqyrës nga përbërja e tij zgjedh kryetar. Mandati i anëtarëve të bordit Mbikqyrës zgjat pesë vite pa të drejtë rizgjedhjeje.

Bordi Mbikqyrës e monitoron punën materialo-financiare të organizatës sindikale më së paku dy here në vit dhe raportet detyrimmisht i përcjell deri te bordi Rajonal i SASHK-ut.

Në rast të parregullësive të konstatuara në punën materialo-financiare, bordi Mbikqyrës e informon kryetarin e organizatës sindikale, bordin Rajonal dhe atë Mbikqyrës të SASHK-ut,

8. BORDET RAJONALE

Neni 31

Në nivel të rajoneve formohen borde rajonale të SASHK-ut.

Bordet Rajonale janë persona juridik me llogari rrjedhëse dhe kanë vulë dhe shtambil.

Kontabiliteti i llogarive-rrjedhëse udhëhiqet në shërbimin Profesional të SASHK-ut.

Bordet Rajonale të SASHK-ut financohen me një pjesë tarifore nga të anëtarësuarit e SASHK-ut, me çka organizatat sindikale e ndajnë në përputhje me Vendimin e Këshillit të SASHK-ut.

Neni 32

Anëtarë të bordeve rajonale janë të gjithë kryetarët e organizatave sindikale të SASHK-ut nga Rajoni specific.

Bordet rajonale:

- negociojnë me organet e vetëqeverisjes lokale për çështjet socio-ekonomike që janë në kompetencë të vetëqeverisjes lokale;
- lidhin marrëveshje kolektive për veprime dhe institucione të cilat financohen nga mjetet e vetëqeverisjes lokale;
- marrin vendime rreth organizimit të formave të ndryshme të presionit: letra protestuese, tubime publike, shëtitje protestuese, demostrata dhe greva, për çështje që janë në competence të vetëqeverisjes lokale;
- japin propozime dhe opinione rreth Buxhetit të vetëqeverisjes lokale sa i përket financimit të veprimtarive.

Bordi Rajonal i SASHK-ut mund të punojë nëse të pranishëm janë më shumë se gjysma e anëtarëve, ndërsa vendimet merren me shumicën e pjesëmarrësve.

Neni 33

Kryetari i bordit Rajonal zgjidhet përmes një konkursi intern, ndërsa zgjedhjen e bën Komisoni për përzgjedhje dhe emërim.

Këshilli i SASHK-ut me vendim të posaçtë formon komision prej 5 anëtarëve për zgjedhje dhe emërim të kryetarit të bordit Rajonal.

Kryetari i bordit Rajonal funksionin e tij e kryen në mënyrë profesionale apo vullnetare.

Kryetari i bordit Rajonal me punën e tij në mënyrë direkte përgjigjet para kryetarit të SASHK-ut.

Kryetari i bordit Rajonal, pas konsultimit paraprak me kryetarin e SASHK-ut, thërret mbledhje të bordit dhe udhëheq me të njëjtat.

Kryetari i bordit Rajonal ka për detyrë që me kohë dhe në mënyrë të drejtë t'a informojë Bordin rreth qëndrimeve, vendimeve, përfundimeve të marra dhe dokumenteve të tjera në Këshillin e SASHK-ut.

Kryetari i bordit Rajonal me funksion është anëtar i Këshillit të SASHK-ut.

Kryetari i bordit Rajonal i SASHK-ut e përfaqeson Rajonin sa i përket qarkullimit tarifor edhe para palëve të treta.

Neni 34

Kyetari i bordit Rajonal ka për detyrë që me kohë t'a informormojë kryetarin e SASHK-ut për të gjitha aktivitetet me rëndësi të veçantë në bordin Rajonal të SASHK-ut dhe në veçanti nëse kryetari i SASHK-ut kërkon informacione me gojë apo shkrim gjatë pyetjeve të caktuara.

Neni 35

Kryetari i bordit Rajonal e bën informimin e opinionit për aktivitetet më të rëndësishme të bordit, përmes njoftimeve, pres-konferencave dhe paraqitjeve të drejpërsëdrejta në mjetet e informimit.

Neni 36

Kryetari i bordit Rajonal e ka për detyrë që t'i ndjekë aktivitetet në secilën organizatë sindikale, ta nxisë dhe ta ndihmojë aktivitetin e tyre, në marrëveshje me kryetarin e organizatës sindikale. Poqese në ndonjërën nga organizatat sindikale nga rajoni konstatohen shkelje të rregulluave nga Statuti i SASHK-ut dhe moszbatim i vendimeve të organeve të SASHK-ut, kryetari i bordit rajonal e ka për detyrë që menjëherë t'a infromojë kryetarin e SASHK-ut, ndërsa në rast të shkeljeve më të rënda të Statutit të SASHK-ut nga individë - anëtarë të organizatës sindikale ka të drejtë të kërkojë sanksionim të tyre edhe para Këshillit të SASHK-ut.

Në rast kur në ndonjë nga institucionet, ku veprojnë organizatat sindikale nga rajoni konkret, krijohen probleme të cilat i tejkalojnë mundësitë e vet organizatës sindikale për zgjidhjen e tyre, kryetari i bordit Rajonal detyrimisht ndërmerr aktivitete, përsmes organeve të vetëqeverisjes lokale apo në marrëveshje me kryetarin e SASHK-ut, përmes organeve kompetente të vendit për tejkalmin e problermeve të krijuara.

Kryetati i bordit Rajonal ka per detyre të thërret mbledhje në Rajon, më së paku një here në tre muaj, ndërsa detyrimisht për çështje më të rëndësishme për të cilat janë në komepetencë të bordit Rajonal.

Kryetari i bordit Rajonal thërret mbledhje të organizatës sindikale, nëse kryetari i organizatës sindikale nuk e ka bërë këtë edhe pse kushte ishin të përmbushura sipas nenit 27, paragrafi 2.

Kryetari i bordit rajonal i SASHK-ut e përfaqëson Rajonin në qarkullimin tarifor - pagesor edhe para palëve të treta.

Kryetari i bordit Rajonal e ruan dokumentacionin, vulën dhe shtambilin në bordin rajonal dhe është edhe nënshkrues i të gjitha dokumenteve dhe urdhërdhënës i të gjitha mjeteve të shfrytëzuara.

Neni 37

Kryetari i bordit Rajonal i SASHK-ut shkarkohet para skadimit të mandatit në rast se e shkel Statutin e SASHK-ut dhe vendimet e Këshillit të SASHK-ut, si dhe për joaktivitet, me çka nuk e kryen funksionin e tij.

Inicim për shkarkim të kryetarit, deri te Këshilli i SASHK-ut, mund që të paraqesin organizatat sindikale të SASHK-ut, të cilat paraqesin më së paku një të tretën e numrit të përgjithshëm, të organizatave sindikale në Rajon.

Inicim për shkarkim mund të paraqesin më së paku një e treta e anëtarëve të Këshillit të SASHK-ut, si dhe kryetari i SASHK-ut.

Vendim për shkarkim të kryetarit të bordit Rajonal me inicim të organizatave sindikale në Rajon, të anëtarëve të Këshillit të SASHK-ut apo të kryetarit të SASHK-ut merr Këshilli i SASHK-ut me shumicën e votave.

Kryetari i bordit Rajonal është me mandat 5 vjeçar dhe me mundësi për rizgjedhje të sërishme.

Mandati i kryetarit të bordit rajonal mund të zgjasë edhe më pak se 5 vite. gjegjësisht deri në ditën e prishjes së Marrëveshjes për punësim me punëdhënësin për arsye moshe, përkatësisht pensionimi.

Mandati i kryetarit i bordit rajonal mund të zgjasë edhe më pak se 5 vite për arsye të përcaktuara në nenin 37, paragrafi 1 nga Statuti i SASHK-ut.

Nëse kryetari i bordit Rajonal është i angazhuar profesionalisht në SASHK apo përsëri nuk rizgjidhet, përkatësisht, nëse para kohe shkarkohet, i kthehet institucionit nga ku ka ardhur në funksion, në një vend të përshtatshëm pune.

Neni 38

Bordi Rajonal zgjedh bord Mbikqyrës me 3 anëtarë dhe 3 anëtarë zëvendës anëtarë.

Bordi Mbikqyrës nga paragrafi 1 i këtij neni mbikqyr punën materialo-financiare të bordit Rajonal më së paku njëherë në vit dhe Raportin e dorëzon deri te Rajoni …

Raportin nga paragrafi 2 të këtij neni, bordi Mbikqyrës e dorëzon deri te bordi Mbikqyrës i SASHK-ut dhe Këshillin e SASHK-ut.

Në rast të parregullsive të konstatuara për punën materialo-financiare, bordi Mbikqyrës e informon bordin Mbikqyrës të SASHK-ut.

9. ORGANET E SASHK-UT

Neni 39

Organe të SASHK-ut janë: Kongresi Këshilli, Kryetari dhe bordi Mbikqyrës.

9.1.KONGRESI

Neni 40

Kongresi është organi më i lartë i SASHK-ut i cili mblidhet në çdo pesë vite. Vendim për datën dhe vendin se ku do të mbahet kongresi, si dhe propozim për rendin ditor të Kongresit merr Këshilli më së voni 60 ditë para mbajtjes së tij.

Propozim - dokumentet për Kongresin vihen për debat para anëtarësisë, më së paku 30 ditë para mbajtjes së Kongresit.

Neni 41

Numri, përbërja dhe struktura e delegatëve të Kongresit përcaktohen me Vendim të posaçtë të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit sipas funksionit janë delegatë të Kongresit.

Neni 42

Që Kongresi të punojë nevojitet prani e dy të tretave të delegatëve të Kongresit ndërsa vendimet janë të plotfuqishme nëse për ta voton shumica e delegatëve të pranishëm të Kongresit. .

Neni 43

Kongresi i ka përgjegjësitë si në vijim:

- miraton Rregullore për punën e Kongresit;
- miraton Statut dhe dokumente programore;
- miraton Raport të Këshillit pët aktivitetet e SASHK-ut dhe Raport të bordit Mbikqyrës;
- miraton zgjedhje të anëtarëve të bordit Mbikqyrës;
- miraton zgjedhje të Kryetarit të SASHK-ut.

Neni 44

Në periudhën ndër-kongresore mund të mbahet një konferencë e SASHK-ut, në të cilën do të bëhet vlerësim për rezultatet e arritura në Programin e SASHK-ut, ku do të dakordohen aktivitetet e mëtejshme.

Neni 45

Numri i pjesëmarrësve si dhe struktura e tyre përcaktohet me Vendim për thirrje të Konferencës, të cilën e bën Këshilli i SASHK-ut.

Neni 46

Kongresi i Jashtëzakonshëm i SASHK-ut mund të thirret me Vendimin e Këshillit të SASHK-ut, me kërkesë të më së paku dy të tretat e organizatave të SASHK-ut.

Vendimin për thirrjen e Kongresit të Jashtëzakonshëm, Këshilli e merr me më së paku dy të tretat nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Për Kongresin e Jashtëzakonshëm të njëjtë janë delegatët nga Kongresi i rregullt.

Me vendimin për mbajtjen e Kongresit të Jashtëzakonshëm, Këshilli duhet t'a përcaktojë një pike të rendit ditor me pytje saktë të definuar, sipas së cilës do të debatohet dhe do të vendoset në Kongresin e Jashtëzakonshëm.

Që të mund të punojë Kongresi i Jashtëzakonshëm nevojitet pjesëmarrje e dy të tretave e delegatëve në Kongresin e Rregullt ndërsa vendimet janë të vlefshme nëse për to përcaktohet shumica e pjesëmarrësve në Kongresin e Jashtëzakonshëm.

9.2. KËSHILLI

Neni 47

Këshilli është organ më i lartë i përhershëm i SASHK-ut, i cili punon dhe vepron mes dy kongreseve.

Neni 48

Këshilli i SASHK-ut është person juridik dhe ka llogari rrjedhëse.

Struktura e Këshillit është e përshtatshme me strukturën e anëtarëve të SASHK-ut sipas veprimtarive.

Vendim për numrin, përbërjen, kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit merr Këshilli i SASHK-ut.

Neni 49

Kryetarët e bordeve Rajonale, kryetari i SASHK-ut, nënkryetarët e SASHK-ut dhe sekretari gjeneral i SASHK-ut me funksion janë antarë të Këshillit të SASHK-ut.

Me propozim të bordeve Rajonale, Këshilli zgjedh edhe anëtarë të Këshillit sipas strukturës.

Anëtarët e Këshillit sipas strukturës janë në pajtim me dispozitat e Nenit 48 të Statutit të SASHK-ut.

Neni 50

Nëse anëtari i Këshillit të SASHK-ut, për tre herë rradhazi mungon pa arsye në mbledhjet e Këshillit, i përfundon funksionimi si anëtar i Këshillit dhe në vend të tij bordi Rajonal, nga ku edhe vjen, bën zgjidhje të re, në pajtim me kryetarin e SASHK-ut.

Neni 51

Këshilli i zbaton funskionet e SASHK-ut, të përcaktuara me këtë Statut dhe vepron në bazë të përcaktmeve programore

Këshilli për punën e tij është përgjegjës para Kongresit të SASHK-ut.

Neni 52

Këshilli punon dhe vendos për çështjet të cilat duhet të jenë në rendin ditor të Këshillit.

Këshilli është në përbërje në pajtim me Nenin 49 të këtij Statuti.

Neni 53

Këshilli i SASHK-ut, i ka kompetencat si në vijim:

- i relaizon dispozitat e Kongresit të SASHK-ut;
- i përcakton dokumenetet e Kongresit;
- miraton programe operative dhe raporte për punën;
- i përcakton intereset e përbashkëta dhe aktivitetet për realizimin e tyre;
- sjell Vendim për autorizimin e kryetarit të SASHK-ut për nënshkrimin e marrëveshjeve kolektive;
- jep propozime dhe opinione gjatë përcaktimit të normativave dhe standardeve për punë të punonjësve në veprimtaritë dhe kriteret për marrjen e titujve, në pajtim me ligjin;
- inicon organizim të grevës gjenerale para organizatave sindikale dhe në bazë të deklaratës së organizatave sindikatale merr Vendim;
- e përgatit planin Financiar dhe e miraton Raportin Financiar për llogarinë rrjedhëse të Këshillit të SASHK-ut;
- sjell vendime për shpalljen e zgjedhjeve të rregullta në SASHK;
- merr vendime për nevojat e SASHK-ut;
- miraton akte me të cilat rregullohet puna e organeve dhe trupave të SASHK-ut;
- formon fonde të SASHK-ut;
- i përcakton bazat e përbashkëta për negocim të marrëveshjes Kolektive;
- me propozime dhe opinione merr pjesë në procedurën për miratimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera, të cilat i rregullojnë interesat e punës - juridiko, socio-ekonomike dhe profesionale, si dhe qëndrime në lidhje me realizimin e tyre;
- merr vendime për shkarkimin e kryetarëve të organizatave sindikale dhe kryetarëve të bordeve Rajonale dhe largimin e anëtarësisë në SASHK, për shkelje të Statutit të SASHK-ut, me propozim të bordit Rajonal të SASHK-ut, anëtarëve të Këshillit të SASHK-ut apo kryetarit të SASHK-ut:

- përcakton Kritere për zgjedhjen e kryetarit të bordit Rajonal të SASHK-ut;
- vendos për ankesën e kandidatëve për kryetarë të bordeve rajonale të SASHK-ut;
- zgjedh koordinatorë për punë në veprimtaritë problematike që i përfaqëson SASHK-u;
- përcakton qëllime të përbashkëta dhe aktivitete me sidnikatat dhe shoqatat tjera në vend dhe jashtë tij;
- zgjedh delegatë për Kongresin e SASHK-ut;
- zgjedh delegate dhe anëtarë në organet dhe asociacionet e tjera;
- propozon kandidatë të mundshëm për kryetar të SASHK-ut;
- propozon kandidatë të mundshëm për kryetar të shoqatave të tjera;
- organizon mbledhje të ndryshme të SASHK-ut;
- miraton aktet pë punë të Shërbimit Profesional të Këshillit të SASHK-ut;
- kryen edhe punë të tjera në pajtim me Statutin.

Neni 54

Në mënyrë që Këshilli të mund të punojë nevojitet që në mbledhjet të marrin pjesë shumica e anëtarësisë, ndërsa vendimet janë fuqiplota nëse për to përcaktohen dy të tretat e anëtarëve të pranishëm.

9.3. KRYETARI I SASHK-UT

Neni 55

Kongresi, me propozim të Këshillit, zgjedh kryetar të SASHK-ut.

Neni 56

Mandati i kryetarit të SASHK-ut zgjat pesë vite dhe i njëjti mund të përsëritet.

Në rast kur kryetari i SASHK-ut pengohet përgjithmonë për kryerjen e funksionit apo jep dorëheqje, Këshilli zgjedh njërin nga dy zëvendëskryetarët për kryerjen e detyrës - kryetar.

Neni 57

Kryetari i SASHK-ut e përfaqëson Këshillin e SASHK-ut në qarkullimin tariforo-pagesor juridik edhe para palëve të treta.

Neni 58

Detyrat e kryetarit janë si në vijim:

- thërret mbledhje të Këshillit dhe kryeson me të;
- zhvillon bisedime dhe negociata me partnerë përkatës në vend dhe i nënshkruan marrëveshjet kolektive sipas aktiviteteve pas Vendimit paraprakisht të marrë për autorizim nga ana e Këshillit, për nënshkrimin konkret të një marrëveshjeje Kolektive;
- i përfaqëson qëllimet dhe interesat e SASHK-ut,
- i drejton aktivitetet e Këshillit në pajtim me Statutin dhe Programin e SASHK-ut;
- merr pjesë në punën e komisionit për zgjedhje të kryetarit në bordin Rajonal të SASHK-ut;
- jep Pëlqim për zgjedhje të kryetarit të bordit Rajonal të SASHK-ut;
- kontakton me mjetet e informimit publik dhe mban konferenca për shtyp:
- realizon bashkëpunim me sindikatat e tjera, shoqatat dhe organizatat joqeveritare;
- krijon kontakte dhe bashkëpunim me sindikatat dhe shoqatat përkatëse nga vendet tjera;

- i nënshkruan të gjitha aktet e Këshillit të SASHK-ut;
- i nënshkruan aktet e veçanta me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve në shërbimin Profesional të Këshillit të SASHK-ut;
- kryetari i SASHK-ut nënshkruan Vendim për zgjedhje të kryetarit të bordit Rajonal të SASHK-ut;
- urdhërdhënës është për mjetet e Këshillit të SASHK-ut dhe fondit të Sindikatave;
- në çdo mbledhje të Këshillit paraqet Raport për aktivitetet më të rëndësishme të SASHK-ut mes dy mbledhjeve të Këshillit;
- kryen edhe punë të tjera në pajtim me këtë Statut,

Kryetari për punën e tij është përgjegjës para Kongresit të SASHK-ut.

Neni 59

Kryetari i SASHK-ut, nëse nuk zgjidhet përsëri apo nëse shkarkohet para kohe, kthehet në institucionin apo kompaninë nga e cila ka ardhur në funksion, në një vend pune të përshtatshme.

Neni 60

Me propozim të kryetarit të SASHK-ut, Këshilli zgjedh sekretar gjeneral të SASHK-ut,

Mandati i sekretarit gjeneral zgjat pesë vite dhe mund të përsëritet.

Neni 61

Sekretari gjeneral i SASHK-ut i ka detyrat si në vijim:

- i përgatit materialet për mbledhjet e Këshillit;
- i koordinon aktivitetet dhe kontakton me bordet Rajonale si dhe me organizatat sindikale;
- e organizon aktivitetin për edukim në SASHK;
- e organizon punën dhe është udhëheqës i shërbimit Profesional të Këshillit të SASHK-ut;
- kryen edhe punë të tjera nën autorizimin e kryetarit të SASHK-ut, në pajtim me Statutin e SASHK-ut.

Nenin 62

Sekretari gjeneral i SASHK-ut, nëse përsëri nuk rizgjidhet apo nëse shkarkohet para kohe, i kthehet institucionit apo kompanisë nga ku ardhur në funksion, në një vend pune të përshtatshme.

Neni 63

Me propozim të kryetarit të SASHK-ut, Këshilli emëron dy zëvendëskryetarë të SASHK-ut.

Nënkryetarët, funksionin e kryejnë në mënyrë vullnetare.

Neni 64

Nënkryetarët e SASHK-ut, me funksion janë anëtarë të Këshillit të SASHK-ut.

Nënkryetarët e SASHK-ut i kanë detyrat si në vijim:

- marrin pjesë në dialogjet sociale me organet kompetente në marrëveshje me kryetarin e SASHK-ut;
- inicojnë aktivitete në Këshill;
- në mungesë të zëvendëskryetarit të SASHK-ut, dhe me autorizim të tij i drejtojnë mbledhjet në SASHK;

- kryejnë edhe punë të tjera në marrëveshje me kryetarin e SASHK-ut, ndërsa në pajtim me Statutin dhe Programiin e SASHK-ut.

9.4. BORDI MBYIKQYRËS

Neni 65

Kongresi zgjedh bord Mbikqyrës me 3 anëtarë dhe 3 zëvendës.

Bordi Mbikqyrës nga strukturat e tij zgjedh Kryetar. Anëtarët e Këshillit nuk mund të jenë anëtarë të bordit Mbikqyrës.

Mandati i anëtarëve të bordit Mbikqyrës zgjat 5 vite, pa mundësi për tu rizgjedhur sërish.

Neni 66

Bordi Mbikqyrës i kryen aktivitetet si në vijim:

- bën mbikqyrje të punës materialo-financiare në Këshillin e SASHK-ut, në fondin Sindikal të SASHK-ut, në bordet Rajonale të SASHK-ut si dhe në organizatat sindikale;
- bën kontrollin e shpërndarjes dhe përdorimin e mjeteve financiare;
- më së paku një here në vit kryen kontroll dhe revision në punën e përgjithshme materialo-financiare të zbatimit të vendimeve, rregulloreve dhe përdorimin e pronës.

Bordi Mbikqyrës ka të drejtë t'a kontrollojë punën financiare të Këshillit të SASHK-ut, të bordeve Rajonale të SASHK-ut si dhe të organizatave sindikale pa paralajmërim paraprak. Për të gjitha kontrollet e kryera, bordi Mbikqyrës përpilon procesverbal dhe të njëjtin e dorëzon deri te Këshilli.

Bashkëpunon me shërbimet e inspektimit, të obliguar për punën financiare, në pajtim me ligjin.

Paraqet raporte për punën materialo-financiare deri te Këshilli i SASHK-ut.

10. FINANCIMI DHE MJETET MATERIALE TË SASHK-ut

Neni 67

Puna e SASHK-ut financohet nga të ardhurat e anëtarsimit dhe të ardhurave të tjera, siç janë: donacionet, sponzorimet, interesat e fondeve, aksionet, faturat bankare dhe dhuratat.

Shuma e anëtarësimit dhe shpërndarja e saj përcaktohet me Vendim të Këshillit të SASHK-ut.

Neni 68

Tarifa e anëtarsimit shlyhet gjatë pagesës së pagave mujore duke bërë llogaritjen përmes listës së pagave.

Neni 69

Moszbatimi i vendimeve për shpërndarjen e tarifës së anëtarsisë për përdorimin e mjeteve konsiderohet si shkelje e Statutit të SASHK-ut.

11. FONDI SINDIKAL I SASHK-UT

Neni 70

Për arritje të ndihmës solidaro-materiale dhe shfrytëzimin e përfitimeve materiale të tjera, në kuadër të SASHK-ut, formohet fondi Sindikal i SASHK-ut (në tekstin e mëtejmë: Fond).

Neni 71

Anëtarë të Fondit janë organizatat sindikale të cilat vullnetarisht kanë vendosur që të anëtarësohen.

Neni 72

Me Fondin udhëheq Kuvendi i Fondit, që e përbëjenë nga një anëtar i secilit Rajon, të deleguar nga anëtarët e Fondit.

Mandati i anëtarëve në Kuvendun e Fondit zgjat 5 vite me mundësi për rizgjedhje të sërishme.

Neni 73

Kuvendi i Fondit me Vendim të posaçtë e përcakton tarifën e anëtarsimit që paguhet në Fond.

Neni 74

Kuvendi i Fondit nga anëtarët e Kuvendit zgjedh një bord Drejtues që përbëhet nga 5 anëtarëve.

Kryetar i Kuvendit dhe i bordit Drejtues, me funksion është kryetari i SASHK-ut.

Neni 75

Me mjetet e Fondit udheëheq bordi Drejtues. Për shfrytëzim individual të të drejtave, të cilat përcaktohen me Rregulloren e fondit Sindikal të SASHK-ut, që e bart Kuvendi i Fondi, vendos kryetari i SASHK-ut.

Neni 76

Anëtarët e Fondit përmes bordeve Rajonale të SASHK-ut bëjnë zgjidhjen e bordit Mbikqyrës të fondit Sindikal të përbërë prej 3 anëtarëve dhe 3 zëvendësve të anëtarëve.

Neni 77

Bordet Rajonale të SASHK-ut dakordohen mes vete për rajonet në të cilat do të zgjidhen anëtarët dhe zëvendësit e anëtarëve të bordit Mbikqyrës, sipas parimit, që të mos zgjidhen dy anëtarë apo zëvendës në të njëjtin rajon.

Neni 78

Bordi Mbikqyrës i SASHK-ut në fund të vitit përgatit Raport për punën financiare të Fondit, që e miraton Kuvendi.

Neni 79

Mandati i anëtarëve të bordit Mbikqyrës dhe zëvendësve të tyre zgjat 5 vite pa mundësi për rizgjedhje të sërishme.

Neni 80

Shpenzimet për funksionimin e Fondit janë në barë të mjeteve të llogarisë rrjedhëse të Fondit.

12.SHËRBIMI PROFESIONAL

Neni 81

Për të kryer punë profesionale, administrative, financiare, teknike dhe punë të tjera për nevojat e SASHK-ut, në kuadër të Këshillit të SASHK-ut, formohet shërbim Profesional.

Numri i përmbaruesve dhe i vendeve të punës rregullohet me një akt të veçantë, miratuar nga Këshilli i SASHK-ut.

13.EMBLEM, FLAMUR, KËNGË SOLEMNE DHE VULË

Neni 82

SASHK-u ka emblem i cili e simbolizon SASHK-un. Emblemi është një rreth me sfond të verdhë në të cilin në një stil të veçantë qëndron një libër me stilolaps, një shtyllë arkeologjike, një lire dhe një top sportiv.

Neni 83

SASHK-u ka flamur personal edhe atë me sfond të kuq, në mes e ngulitur emblema e SASHK-ut.

Neni 84

SASHK-u ka një himn të quajtur ‘’Përgjithmonë SASHK’’, me melodi dhe tekst që e simbolizojnë SASHK-un

Himni përdoret në të gjitha aktivitetet e rëndësishme të SASHK-ut, duke filluar nga organizatat sindikale, bordet rajonale e deri tek organet e SASHK-ut.

Himni “Përgjithmonë SONK”, detyrimisht këndohet, drejtpërdrejt apo me intonim të një regjistrimi gjatë mbajtjes së Kongresit të rregullt apo të jashtëzakonshëm të SASHK-ut, si dhe në aktivitete të SASHK-ut në të cilat marrin pjesë edhe mysafirë nga organizatat sindikale apo federatat nga jashtë vendit, e që mbahen në Republikën e Maqedonisë.

Neni 85

Në SASHK të drejtë vule kanë Këshilli, bordet Rajonale dhe organizatat sindikale.

Vula e SASHK-ut është e rrumbullakët dhe e përmban emrin si në vijim: SINDIKATA E PAVARUR PËR ARSIM, SHKENCË DHE KULTURË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË - SHKUP.

Vula e bordit Rajonal të SASHK-ut është e rrumbullakët dhe e përmban emrin si në vijim; SINDIKATA E PAVARUR E SASHK-UT PËR ARSIM, SHKENCË DHE KULUTRË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISE - Bordi Rajonal i SASHK-ut_____ (emri i Rajonit dhe selia).

Vula e organizatës sindikale është e rrumbullakët dhe e përmban emrin si në vijim: SINDIKATA E PAVARUR PËR ARSIM, SHKENCË DHE KULTURË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË - organizata sindikale në _____.

Në mes të vulës të Këshillit, në bordet Rajonale dhe në vulën e organizatave sindikale qëndron emblem i SASHK-ut.

Neni 86

14 Korriku shpallet si DITA E SASHK-ut. Festimi bëhet pas Programit të Këshillit të SASHK-ut.

14. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 87

Statutin e miraton Kongresi i SASHK-ut.

Ndryshime dhe plotësime të Statutit mes dy kongreseve bën Këshilli i SASHK-ut, me dy të tretat e shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Interpretim të dispozitave nga ky Statut jep Komisioni Statutar.

Neni 88

Vendim për bashkim dhe shpërbërje në shoqatat sindikale në vend dhe jashtë vendit jep Këshilli i SASHK-ut.

Neni 89

SASHK-u mund të pushojë së ekzistuari në pajtim me rastet e përcaktuara me Ligj.

Neni 90

Në organizatat sindikale, në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në të cilat edhe përpos përdorimit të gjuhës dhe alfabetit maqedonas për përdorim zyrtar është edhe gjuha dhe alfabeti i qytetarëve, Këshilli i SASHK-ut dhe bordet Rajonale të SASHK-ut sigurojnë komunikim me shkrim me oranizatat sindikale edhe në gjuhë tjetër.

Neni 91

Ky Statut hy në fuqi nga dita e publikimit.

Neni 92

Me hyrjen në fuqi të këtij Stauti, shpallet i pavlefshëm Statuti i SASHK-ut i publikuar më 25-10-2019.